

TERMAT & KUSHTET

Fushata “Formula Uno Monza Experience”

Periudha e fushates

- Fushata zhvillohet nga data 29 Qershor 2026 deri më 9 Gusht 2026 (përfshirë).
- Të gjithë klientët që plotësojnë kushtet e kualifikimit gjatë kësaj periudhe përfshihen automatikisht në short.
- Në short do të merren në konsideratë vetëm transaksionet e vlefshme që janë reflektuar (postuar) në statement-in e klientit deri më datën 11.08.2026.
- Fushata realizohet në formën e një shorteu promocional, ku pjesëmarrësit kanë mundësinë të fitojnë një çmim nëpërmjet përzgjedhjes rastësore.

Kushtet e pjesëmarrjes

- Pjesëmarrës në fushatë mund të jenë të gjithë klientët individualë që janë mbajtës të kartave Mastercard Debit dhe/ose Kredit të lëshuara nga Banka Kombëtare Tregtare.
- Për t’u kualifikuar për short, klientët duhet të kryejnë minimumi 20 transaksione të vlefshme gjatë periudhës së fushatës.
- Çdo transaksion duhet të ketë një vlerë minimale prej 3,000 ALL për t’u konsideruar i vlefshëm.
- Në rast se një klient përdor njëkohësisht kartë debiti dhe kartë krediti, pjesëmarrja do të konsiderohet për secilën kartë në mënyrë të veçantë, transaksionet nuk do të mblidhen.
- Punonjësit e Bankës Kombëtare Tregtare sh.a. përjashtohen nga pjesëmarrja në këtë lojë promotionale.

Transaksionet e vlefshme

- Transaksione të vlefshme konsiderohen të gjitha pagesat e kryera në POS fizik dhe në kanale e-commerce (online), si brenda ashtu edhe jashtë Shqipërisë.
- Nuk konsiderohen të vlefshme transaksionet e refuzuara, të anuluar apo të rimbursuara, pagesat e kredive, si dhe çdo transaksion i cili nuk është përmendur shprehimisht që është pjesë e fushatës.

Mekanizmi i gjenerimit të biletave

- Çdo transaksion i vlefshëm gjeneron një (1) biletë elektronike pjesëmarrëse në short.
- Të gjitha transaksionet e vlefshme regjistrohen në një databazë të strukturuar, ku çdo transaksion përfaqësohet nga një rresht unik.
- Secilit transaksion i korrespondon një numër rendor unik, i cili gjenerohet në mënyrë kronologjike dhe progresive gjatë gjithë periudhës së fushatës.
- Numrat rendorë fillojnë nga 00001 dhe vazhdojnë deri në numrin total të transaksioneve të regjistruara, duke përfaqësuar bileta të veçanta për pjesëmarrje në short.

- Sa më i lartë të jetë numri i transaksioneve të kryera nga një pjesëmarrës, aq më i lartë është numri i biletave dhe rrjedhimisht probabiliteti për t'u përzgjedhur si fitues.

Organizimi dhe zhvillimi i shortit

- Shorteu do të zhvillohet në datën 14 Gusht 2026, në orën 11: 00 në ambientet e Drejtorisë Qendrore të BKT-së, Rruga e Vilave Lundër, Tiranë, Shqipëri, në përputhje me rregulloren e organizimit të llotarive.
- Procesi organizohet nga Banka në prani të një komisioni të brendshëm, për të garantuar transparencën dhe korrektësinë.
- Në proces mund të marrin pjesë edhe përfaqësues të institucioneve rregullatore, sipas kërkesave ligjore.
- Përpara zhvillimit të shortit, Banka do të finalizojë listën e biletave pjesëmarrëse, ku çdo biletë do të ketë një numër rendor unik.
- Fituesi do të përzgjidhet në mënyrë rastësore nëpërmjet mekanizmit të shortit me gogla/globe numerike, duke gjeneruar një numër fitues brenda intervalit të numrave rendorë të biletave të kualifikuara.
- Për këtë qëllim, do të përdoren aq gogla/globe numerike sa është numri i shifrave të numrit më të madh rendor të gjeneruar në listën finale të biletave pjesëmarrëse. Çdo gogël/glob përmban shifrat nga 0 deri në 9 dhe shifrat do të tërhiqen një nga një, në mënyrë rastësore, për të formuar numrin fitues. Në rast se numri i formuar është jashtë intervalit të biletave të vlefshme, i paplotë, i pavlefshëm, ose i përket një bilete që nuk plotëson kushtet e fushatës, procesi i tërheqjes përsëritet sipas të njëjtit mekanizëm deri në identifikimin e një bilete fituese të vlefshme.
- Numri fitues do të gjenerohet në prani të komisionit mbikëqyrës, nëpërmjet një metode transparente për përzgjedhje rastësore, e cila garanton mundësi të barabarta për çdo biletë pjesëmarrëse.
- Komisioni mbikëqyrës verifikon përputhjen e numrit fitues me biletën përkatëse, dokumenton rezultatin dhe garanton transparencën dhe korrektësinë e procesit.

Njoftimi dhe pranimi i fituesit

- Fituesi kontaktohet menjëherë pas shortit nëpërmjet numrit të telefonit të regjistruar në sistemin e bankës.
- Banka kryen deri në tre (3) tentativa të njëpasnjëshme për kontaktimin e fituesit.
- Në rast se fituesi nuk përgjigjet, Banka rezervon të drejtën të përzgjedhë një fitues të ri.
- Fituesi duhet të konfirmojë pranimin e çmimit në momentin e marrjes së njoftimit ditën e hedhjes së shorteut.
- Në rast refuzimi të çmimit nga fituesi, përzgjidhet një fitues tjetër sipas të njëjtit mekanizëm.

Çmimi

- Fituesi përfiton një paketë udhëtimi për dy (2) persona (fituesi + një shoqërues mbi 18 vjeç) për ndjekjen e Formula 1 Grand Prix në Monza, Itali.
- Paketa përfshin transport ajror vajtje-ardhje, akomodim për 4 ditë dhe 3 net në hotel 4★ në Milano (04-07 Shtator 2026), transfertat dhe mëngjesin në hotel.
- Paketa përfshin gjithashtu akses në event, eksperiencë në pistë (përfshirë Hot Lap Experience për 1 person) dhe aktivitete të organizuara si darka dhe evente sociale.
- Pjesëmarrja në event i nënshtrohet kushteve të organizatorëve përkatës, të cilat duhet të pranohen nga fituesi dhe shoqëruesi i tij.
- Çdo shpenzim personal, përfshirë por pa u kufizuar në sigurimin e udhëtimit, shpenzimet mjekësore, taksat turistike apo çdo lloj shpenzimi tjetër që nuk është shprehimisht i përfshirë në përshkrimin e çmimit, do të mbulohet nga ana e fituesit.
- Çmimi nuk është i transferueshëm ose i zëvendësueshëm.

Detyrimet tatimore

- Çdo detyrim tatimor që lind nga përfitimi i çmimit trajtohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- Në rastet kur është e aplikueshme, Banka do të mbajë dhe paguajë tatimin në burim sipas kërkesave ligjore.

Mbrojtja e të dhënave personale

- Të dhënat personale të pjesëmarrësve përpunohen nga Banka Kombëtare Tregtare sh.a., si kontrolluese e të dhënave, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Politikën e Privatësisë së Bankës, të publikuar në faqen zyrtare të saj: <https://www.bkt.com.al/politikat-e-privatesise>
- Për qëllime të administrimit të fushatës, zbatimit të kushteve të saj, verifikimit të përmbushjes së kriterëve të pjesëmarrjes, gjenerimit të biletave elektronike pjesëmarrëse në short, përzgjedhjes rastësore dhe njoftimit të fituesit, si dhe realizimit të çmimit, Banka mund të përpunojë të dhëna identifikuese dhe kontakti të pjesëmarrësve, si dhe të dhëna të lidhura me transaksionet e kryera me kartë Mastercard Debit dhe/ose Kredit, vetëm në masën e nevojshme për këto qëllime. Përpunimi mund të kryhet gjithashtu kur është i nevojshëm për përmbushjen e detyrimeve ligjore, rregullatore, tatimore ose të auditimit që mund të zbatohen ndaj Bankës në lidhje me organizimin e fushatës.
- Në rast se fituesi pranon çmimin, Banka mund të përpunojë të dhëna shtesë të fituesit vetëm për qëllime të organizimit të udhëtimit, akomodimit, transfertave, aksesit në event dhe aktiviteteve të lidhura me çmimin.

- Në funksion të realizimit të çmimit, të dhënat personale mund të ndahen, vetëm në masën e nevojshme, me palë të treta të përfshira në organizimin e udhëtimit dhe eventit, duke përfshirë, sipas rastit, agjenci udhëtimi, ofrues të shërbimeve të akomodimit, transportit, organizatorë të eventit dhe partnerë të tjerë të përfshirë në realizimin e paketës së çmimit.
- Çdo transferim i të dhënave personale jashtë Republikës së Shqipërisë, nëse është i nevojshëm për realizimin e çmimit, do të kryhet në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe vetëm për qëllimet e përcaktuara në këtë klauzolë.
- Të dhënat personale do të ruhen për aq kohë sa është e nevojshme për administrimin e fushatës, realizimin e shortit, verifikimin dhe dorëzimin e çmimit, si dhe për përmbushjen e detyrimeve ligjore, rregullatore, tatimore ose të auditimit që mund të zbatohen ndaj Bankës.
- Pjesëmarrësit gëzojnë të drejtat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, të cilat mund të ushtrohen në përputhje me mënyrat dhe kushtet e përcaktuara në Politikën e Privatësisë së Bankës, të publikuar në faqen zyrtare të saj.
-

Forca madhore

- Në rast ndryshimi apo anulimi të eventit për arsye madhore dhe të jashtme, banka nuk mban përgjegjësi dhe nuk aplikohet kompensim alternativ
- Me “arsye madhore” nënkuptohen rrethana jashtë kontrollit të Bankës, duke përfshirë por pa u kufizuar në anulimin, shtyrjen apo ndryshimin e eventit nga organizatorët, vendime të autoriteteve publike, fatkeqësi natyrore apo situata të tjera të paparashikuara.

Transparenca

- Rregullat e plota të kësaj fushate publikohen në faqen zyrtare të Bankës, me qëllim garantimin e transparencës dhe informimit të plotë të pjesëmarrësve.

Dispozita përfundimtare

- Banka rezervon të drejtën të përjashtojë nga fushata çdo pjesëmarrës në rast konstatimi të abuzimeve apo shkeljeve të këtyre kushteve.
- Banka rezervon të drejtën të verifikojë përmbushjen e të gjitha kushteve të pjesëmarrjes nga fituesi përpara dorëzimit të çmimit.
- Kjo fushatë organizohet vetëm dhe ekskluzivisht nga Banka. Mastercard nuk mban përgjegjësi për llogaritjen e kualifikimit të transaksioneve, ndarjen e biletave, përzgjedhjen e fituesve, shpërndarjen e çmimeve, detyrimet tatimore apo trajtimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale, përveç rasteve kur është shprehimisht e përcaktuar në këto Kushte.